



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 korrik 2017  
Nr. ref.:RK 1099/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI54/16**

Parashtrues

**Ramadan Demirović**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-002/14, të 14 tetorit 2015**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ramadan Demirović nga Dragashi, me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Agjencisë Kosovare të Pronës GSK-KPA-A-002/14 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 14 tetorit 2015, i cili i është dorëzuar më 14 dhjetor 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të lartcekur të Kolegjit të Apelit, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], nenin 8 [E Drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 18 mars 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 22 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dorëzoi Kolegjit të Apelit.
8. Më 9 qershor 2016, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës një letër me të cilën kërkoi të paraqesë dokumente shtesë, si dhe fletëkthesën kur i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar.
9. Më 17 qershor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë, si dhe fletëkthesën për dorëzimin e aktgjyimit.
10. Më 31 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës deri në vitin 1999 ka jetuar në një banesë e cila gjendet në Prishtinë, me adresë në Dardani SU 9/1 L2, kati VII, numri i banesës 30.
12. Parashtruesi i kërkesës në vitin 1999 është larguar nga Prishtina dhe në banesën e lartpërmendur janë vendosur personat B.D dhe L.D.
13. Në një ditë të panjohur, parashtruesi dorëzoi kërkesë për riposedit të pronës së tij në Drejtorinë për çështje pronësore dhe banesore (në tekstin e mëtejme: DÇPB). Kjo kërkesë u regjistrua me numër DS302305.
14. Në një ditë tjetër të pacaktuar, personat B.D. dhe L.D. gjithashtu parashtruan kërkesë në DÇPB, e cila u regjistrua me numër DS000369, me të cilën kërkuan kthimin e të drejtës pronësore mbi pronën lëndore. Kjo kërkesë ishte bazuar në kontratën mbi bashkimin e mjeteve nr. 01-982 të 12 majit 1986.
15. Më 18 qershor 2004, Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore (në tekstin e mëtejme: KKPB) nxori Vendimin [HPCC/D/137/2004/A&C] me të cilin aprovoi kërkesën nr. DS000369 të parashtruesve B.D. dhe L.D dhe iu ka njohur të drejtat si klientë të kategorisë “A”, sepse ata kishin fituar të drejtat pronësore para vitit 1989, dhe prandaj ata e fituan të drejtën për kthimin e pronës së patundshme lëndore.
16. KKPB kërkesën e parashtruesit DS302305 e regjistroi si kërkesë të kategorisë “C” dhe me të njëjtin vendim e refuzoi kërkesën si të pabazuar.
17. Parashtruesi i kërkesës në afat dorëzoi ankesë në kolegjin e shkallës së dytë të KKPB-së kundër vendimit [HPCC/D/137/2004/A&C], duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit të shkallës së parë.
18. Më 11 dhjetor 2006, kolegji i shkallës së dytë të KKPB-së nxori vendim grupor [HPCC/REC/86/2006], me të cilin kërkesën e parashtruesit për rishqyrtimin e vendimit të shkallës së parë të KKPB-së e refuzoi si të pabazuar.
19. Më 16 tetor 2006, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 ka hyrë në fuqi; me këtë Rregullore u themelua Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), si pasardhëse ligjore e DÇPB-së.
20. Më 17 tetor 2007, duke shfrytëzuar mundësinë ligjore, të cilën ia dha Rregullorja e re e UNMIK-ut [2006/50], parashtruesi dorëzoi kërkesë pronësore në AKP për njohjen e të drejtave të pronësisë mbi pronën lëndore.
21. Më 18 prill 2013, me Vendimin [KPCC/D/R/199/2013], Komisioni për kërkesa pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) e refuzoi kërkesën pronësore të parashtruesit pasi i nënshtrohej vendimit *res judicata*. KKPK-ja arsyetoi se:

*“Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni e hedh poshtë kërkesën e cila është shqyrtuar më parë dhe është vendosur me vendim administrativ ose gjyqësor të formës së prerë. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë.”*

22. Më 23 janar 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) kundër Vendimit [KPCC/D/R/199/2013] të KKPK-së, duke pretenduar *“se nuk bëhet fjalë për res judicata, për shkak se janë në pyetje dy kërkesa të ndryshme - njëra për të cilën tashmë është vendosur në vitin 2006, dhe bëhet fjalë për posedim të sërishëm të banesës, ndërsa tjetra, të cilën ai e parashtroi në vitin 2007, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë.”*
23. Më 14 tetor 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin [GSK-KPA-A-002/14], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit me arsyetimin se:

*“Paraqitësi i kërkesës deklaroi se çështja e lëndës tani është ndryshe nga çështja e lëndës e cila është vendosur në procedurën e mëparshme. Ai pretendon se DÇBP/KKBP është dashur të vendosë sipas kërkesës së tij pronësore përkitazi me të drejtën e shfrytëzimit derisa tani është në pyetje e drejta e tij e pronësore. Gjyqi konstaton se ky pretendim është i gabuar. KKBP ka vendosur në rastin e dy kërkesave: kërkesën pronësore të kategorisë “A” të të paditurit lidhur me rikthimin e të drejtës së tij pronësore në pronën në kërkesë dhe kërkesën pronësore të kategorisë “C” të ankuesit lidhur me posedimin e sërishëm të të drejtës pronësore (pronës), posedimit të ligjshëm apo të drejtës së shfrytëzimit ose të drejtës së banimit në pronën në kërkesë.*

*Në këtë mënyrë, çështja ndërmjet të të pandehurit dhe ankuesit se kush është pronar i pronës-kush e ka pronësinë-e pronës në kërkesë tashmë është zgjidhur nga ana e KKBP-së. Pra, vendimi i KKBP-së lidhur me të drejtën pronësore të pronës në kërkesë ndërmjet ankuesit dhe të të pandehurit është res judicata. Kështu, e drejta pronësore tashmë e refuzuar nuk mund të jetë lëndë e rishqyrtimit në procedurën e tanishme.”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Me trajtimin e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe vendimet e mëparshme të KKPB-së (HPCC) dhe KKPK-ja (KPCC) janë shkelur të drejtat e mia të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Banesa objekt i ankesës ishte shtëpia ime, në të cilën kam jetuar me anëtarët e familjes sime dhe tani e drejtë në shtëpi më është marrë dhe banesa është dhënë një personi tjetër.”*
25. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon: *“Meqë jam pjesëtarë i pakicës etnike në Kosovë, qartë mund të arrihet në përfundim se pjesëtarët e grupit etnik shumicë nuk përballen me probleme të ngjashme me ato që unë po përballem*

*dhe është e qartë se nuk ka barazi para ligjit dhe mbi këtë bazë ndaj meje po bëhet diskriminim.”*

26. Parashtruesi kërkon që Gjykata, në bazë të shkeljeve të konstatuara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, t'i urdhërojë autoritetet në Kosovë për ta mënjanuar sa më shpejt shkeljen e pretenduar të Kushtetutës.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

29. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

30. Në lidhje me atë që u tha më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën si individ edhe në cilësinë e palës së autorizuar, se ka treguar për shkeljet e mundshme kushtetuese; kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se janë përmbushur të gjitha kriteret formale të pranueshmërisë që kërkesa të shqyrtohet.

31. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (3) (g) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”*

*(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

*[...]*

*g) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”*

32. Në këtë rast, Gjykata me shikimin në shkresat e lëndës dhe pretendimet e parashtruesit konstatoi se ai kishte dy procedura në gjykatat e rregullta dhe që të dy procedurat u vendosen me vendime të formës së prerë.
33. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës ngre pretendime kushtetuese në të dyja procedurat. Ai pretendon se “*vendimet e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe vendimet e mëparshme të KKPB-së (HPCC) dhe KKPK-së (KPCC)*” kanë ndikuar në të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë Evropiane.
34. Gjykata vëren se procedurën e parë parashtruesi e inicioi me kërkesën DS302305 të cilën e paraqiti në DÇPB, ku kërkoi që t’i lejohet riposedimi i pronës lëndore.
35. Gjithashtu, Gjykata vëren se procedura e parë ka përfunduar më 11 dhjetor 2006 me vendimin e formës së prerë [HPCC/REC/86/2006] të kolegjit të shkallës së dytë të HPCC-së, ku është zgjidhur kontesti lëndor i kësaj kërkesë.
36. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se veprimet dhe vendimet në lidhje me procedurën e parë të parashtruesit janë zhvilluar në rrethana të ndryshme dhe në kohë kur Gjykata nuk kishte juridiksion kohor, dhe si të tilla nuk janë *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008 (shih, për shembull, rastin: nr. KI47/14 parashtruesi i kërkesës: *Mustaf Zejnullahu*, Aktvendimi për papranueshmërinë i 11 gushtit 2014, paragrafi 25).
37. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (3) (g) të Rregullores së punës, kërkesa në lidhje me grupin e parë të procedurave, duhet të hidhet poshtë pasi nuk është *ratione temporis* me Kushtetutën.
38. Sa i përket procedurës së dytë, Gjykata vëren se ajo ka të bëjë me kërkesën të cilën parashtruesi e dorëzoi më 17 tetor 2007 në AKP, ku kërkoi njohjen e të drejtave të pronësisë mbi pronën lëndore. KKPK-ja ka vendosur në shkallën e parë lidhur me këtë kërkesë më 18 prill 2013, dhe Kolegji i Apelit ka vendosur në shkallë të fundit për këtë kërkesë më 14 tetor 2015.
39. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se gjatë vendosjes mbi kërkesën e tij, gjykatat e rregullta ia kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të

Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së.

**i) Pretendimet për shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së**

40. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata së pari thekson se drejtësia e një procesi vlerësohet në bazë të procedurës në tërësi (shih rastin: *GJEDNJ, Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, kërkesa nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, në përcaktimin e bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesit Gjykata edhe do t'i përmbahet këtij parimi.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, sepse nuk arriti në procedurën kontestimore para KKPK, dhe më vonë edhe në procedurën e apelit para Kolegjit të Apelit, ai nuk e fitoi kërkesën për të drejtën e tij pronësore, për shkak se gjykatat më shumë i vlerësuan dhe i dhanë rëndësi pretendimeve dhe kërkesave të paditurit.
42. Gjykata rikujton se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe për këtë arsye nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih: rasti i *GJEDNJ-së Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65. Shih edhe: *mutatis mutandis* Gjykata Kushtetuese rasti KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).
43. Gjykata para së gjithash thekson se qëllimi i nenit 31 i Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së, ndër të tjera, është që gjykatave t'i caktohen detyrat për të kryer verifikimin e përcaktuar të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar vlerësimin dhe rëndësinë e tyre në lidhje me vendimet gjyqësore (shih rasti: *GJEDNJ, Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993, kërkesa nr. 13942/88).
44. Gjithashtu, neni 6.1 i KEDNJ-së kërkon që në mes të palëve në procedurë të vendoset një barazi e drejtë, gjegjësisht të ekzistojë barazia ndërmjet palëve në procedurë (shih rastin: *GJEDNJ, De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 24 shkurtit 1997, kërkesa nr. 19983/92).
45. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i morën parasysh të gjitha pretendimet e të dyja palëve në procedurë, parashtruesit si paditësit dhe të paditurit, gjatë përcaktimit të së drejtës pronësore ndaj pronës lëndore, dhe i vendosi në pozitë të barabartë, duke iu mundësuar që të paraqesin argumentet e tyre dhe provat.

46. Gjykata më tej vëren se Kolegji i Apelit në mënyrë specifike i ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës se objekti i çështjes në kërkesën e dytë është e natyrës së ndryshme nga ajo që u vendos në procedurën e parë, dhe për këtë arsye çështja nuk është *res judicata*.
47. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i mori parasysh shkaqet e ankesës së parashtruesit të kërkesës që adresuan çështjen e vendimit *res judicata*, dhe Kolegji i Apelit konkludoi se pala e paditur ishte konstatuar të jetë paditës i kategorisë “A”, sepse ai kishte të drejtat e tij pronësore, mbi pronën lëndore. Për sa i përket kërkesës së parashtruesit, Kolegji i Apelit konstatoi se ai ishte paditës i kategorisë “C”, sepse ai në fakt kurrë nuk kishte pasur të drejtë ndaj pronës lëndore.
48. Prandaj, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet të cilat i kishte ngritur parashtruesi i kërkesës gjatë procedurës së rregullt, me ç’rast dha konkluzione të qarta se pse këto pretendime ishin të pabazuara.
49. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së janë të pabazuara.

**ii) Pretendimet për shkelje të nenit 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNJ-së**

50. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 8 të KEDNJ-së lidhur me “*të drejtën në banesë*”, Gjykata thekson se sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së “*banesa*” ka kuptim autonom dhe supozon, në fakt, se personi ka zhvilluar marrëdhënie vendbanimi ndaj vendit ku jeton. Vetëm tek një gjendje e tillë e vërtetuar banesa e saktësuar mund të konsiderohet si shtëpi ndërsa personi i veçantë mund të gëzojë mbrojtjen e të drejtave të qasjes dhe banimit (shih rastin: GJEDNJ, *Wiggins kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 7456/76, nr. 40, viti 1978).
51. Gjykata thekson se neni 8 i KEDNJ-së mbron të drejtën e një individi për të respektuar banesën e tij dhe përcakton mosndërhyrjen e pushtetit në këtë të drejtë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.
52. Megjithatë, Gjykata vëren se në këtë rast parashtruesi i kërkesës nuk cek asnjë ndërhyrje në banesën e tij nga ana e pushtetit, por konsideron se vetëm ai ka të drejtën e qasjes në pronën, pronar i së cilës e konsideron veten. Sipas vendimeve të gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës kurrë nuk e ka pasur të drejtën e pronësisë mbi banesën. Prandaj, objekt i ankesës së tij është e drejta për të fituar pronësinë ndaj banesës dhe jo ndërhyrja në të drejtën tashmë të fituar të parashtruesit.
53. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së janë të pabazuara.



**iii) Pretendimet për shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së**

54. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat, gjithashtu, ia kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
55. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se e drejta të cilën parashtruesi pretendon se e ka fituar, mund të ishte konsideruar si e drejta në pronë, nëse për atë do të ekzistonte baza ligjore, gjegjësisht, nëse banesën lëndore do ta kishte fituar në pajtim me rregullat ligjore përmes trashëgimisë apo me veprime juridike të vlefshme.
56. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat në vendimet e tyre konstatuan se parashtruesi i kërkesës nuk mund të jetë bartës i të drejtave të pronësisë ndaj pronës lëndore, sepse të drejtat e pronësisë janë mbajtur nga një person tjetër para parashtruesit të kërkesës që e kishte zënë banesën. Si i tillë, parashtruesi nuk ka mundur të marrë pronësinë sipas ligjeve në fuqi gjatë periudhës së zotërimit të tij.
57. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka fituar pronën në kuptimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi që e drejta në pronë nuk ekziston deri në momentin kur personi nuk e ka të konstatuar të drejtën ndaj pasurisë së caktuar lëndore. Me fjalë të tjera, e drejta në pronë nuk përfshin edhe të drejtën për ta fituar pronën (shih rastin: GJEDNJ, *Marckx kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, kërkesa nr. 6833/74).

**iv) Pretendimet për shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës dhe nenit 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së**

58. Parashtruesi i kërkesës konsideron se, pasi që është pjesëtar i një komuniteti pakicë në Kosovë, ai është diskriminuar gjatë tërë procedurës, që është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ-së.
59. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se diskriminimi ekziston nëse rezulton në një trajtim të ndryshëm të personave tjerë në pozicione dhe situata të ngjashme, dhe në qoftë se ky ndryshim nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Në mënyrë që të jetë i justifikuar, trajtimi duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të shfrytëzuara dhe qëllimit që kërkohet të realizohet (shih rastin: Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Marckx kundër Belgjikës*, 13 qershor 1979, kërkesa nr. 6833/74).
60. Për këtë arsye është e nevojshme që në çdo rast konkret të përcaktohet nëse parashtruesi është trajtuar ndryshe nga të tjerët në situata të njëjta ose të ngjashme. Çdo trajtim i ndryshëm do të konsiderohet diskriminues, nëse nuk ka justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, përkatësisht nëse nuk ndjek një qëllim

legjitim apo nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme ndërmjet mjeteve të shfrytëzuara drejt atij qëllimi.

61. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, përveç pretendimeve të tij paushalle për shkelje të së drejtës në fjalë, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë argument për të sugjeruar se ai ishte në ndonjë mënyrë i diskriminuar nga gjykatat në procedurën lëndore.
62. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të ndalimit të diskriminimit nga neni 24 i Kushtetutës dhe neni 14 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë janë të pabazuara.
63. Nga të gjitha që u thanë më lart, Gjykata këtë kërkesë të parashtruesit e sheh si shprehje të pakënaqësisë me faktin se kërkesa e tij me të cilën kërkoi realizimin e të drejtave të tij pronësore është refuzuar si e pabazuar në të gjitha instancat, që në rastin konkret nuk është drejtpërdrejtë apo tërthorazi, rezultat i mungesës së një gjykimi të drejtë.
64. Për këtë arsye, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk siguron fakte dhe dëshmi që mund të justifikojnë pretendime të tjera për shkeljen e të drejtave të referuara, e për çka nuk ka as elemente të cilat *prima facie* tregojnë se do të ishte i nevojshëm shqyrtimi meritor.
65. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se kërkesa është qartazi e pabazuar nëse i mungojnë dëshmitë *prima facie*, të cilat me qartësi të mjaftueshme tregojnë se shkelja e përmendur e të drejtave dhe lirive të njeriut është e mundur (shih rastin: GJEDNJ, *Vanek kundër Sllovakisë*, Aktgjykimi i 31 majit 2005, kërkesa nr. 53363/99), nëse faktet në lidhje me të cilat parashtrohet kërkesa në mënyrë të qartë nuk përbëjnë shkelje të të drejtave të cilat parashtruesi i përmend, përkatësisht nëse parashtruesi nuk ka “kërkesë të arsyeshme” (shih rastin GJEDNJ, *Mezőtúr-Tiszazug Vizagalkodasi Társulata kundër Hungarisë*, Aktgjykimii 26 korrikut 2005, kërkesa nr. 5503/02).
66. Si përmbledhje, Gjykata vlerëson se në procedurën e kryer nuk ka fakte apo rrethana që në ndonjë mënyrë do të tregonin se, në procedurën para gjykatave të rregullta, parashtruesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë apo KEDNJ.
67. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

68. Prandaj, kërkesa sa i përket ankesave në lidhje me grupin e parë të procedurave, ato janë të papajtueshme *ratione temporis* me juridiksionin e Gjykatës, në pajtim me rregullin 36 (3) (g) të Rregullores së punës.
69. Sa i përket ankesave në lidhje me grupin e dytë të procedurave, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në përputhje me nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d), 2 (b) dhe (3) (g) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 maj 2017, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

  
Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Arta Rama-Hajrizi

